

Genciana Abazi-Egro (1970-2024)

Më datën 25 gusht 2024 është ndarë nga jeta në moshën 53-vjeçare studiuesja Genciana Abazi- Egro, prej vitesh punonjëse shkencore pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë).

Formimin universitar pranë Universitetit të Tiranës (në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe) ajo e ka përfunduar në vitin 1993; studimet pasuniversitare pranë Universitetit të Ankarasë i ka përfunduar në vitin 1996, ndërsa ato doktorale në vitin 2001. Në interesat e saj studimore kanë bërë pjesë që në krye të herës çështje të leksikologjisë, të traditave letrare e filologjike, studimet historike dhe historiografike.

Genciana Abazi-Egro ka qenë studiuese e afirmuar në fushë të gjurmimeve mbi tekstologjinë dhe orientalistikën, mbi letërsinë e divanit dhe figurat kryesore të rrymës letrare të autorëve që kanë shkruar me alfabet arab. Ndër ndihmesat e saj spikasin dhe analizat tekstore që mëtojnë të saktësojnë autenticitetin e krijimeve që më herët u janë atribuar autorëve që kanë përfaqësuar letërsinë shqipe me alfabet oriental. Genciana Egro është autore e dy botimeve të rëndësishme kritike të veprave të Nezim Beratit (2009) dhe Hasan Zyko Kamberit (2017), realizuar dhe dalë nga shtypi nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Departamenti i Studimeve Letrare). Ndër orientimet studimore të punës së saj kërkimore duhen përmendur dhe kontributet për klasifikimin e turqizmeve në gjuhën shqipe dhe gjurmime mbi mjetet e formimit që dëshmojnë vijimësinë e ndikimit përkatës nga turqishtja në fjalëformimin e shqipes (Shih në veçanti kumtimin me titull “Vështrim i përgjithshëm mbi formantet turke në fjalëformimin e shqipes”, botuar në *Seminari XVIII ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*; përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumesave dhe e diskutimeve, Tiranë 19-31 gusht 1996).

Një kontribut i spikatur i saj me vështrim nga onomastika historike mbetet dhe ai me titull “Deti Adriatik dhe viset e Ballkanit në perceptimin e kronistëve osmanë të shek. XV”, botuar në përmbledhjen studimore me titull *Skënderbeu dhe Evropa*, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2006.

Genciana Egro është autore e një numri të konsiderueshëm shkrimesh dhe artikujsh shkencorë mbi autorë, dukuri e vepra që lidhen me letërsinë shqipe të shkruar me alfabet arab, por dhe drejtuese shkencore e disa punimeve doktorale të mbrojtura me sukses në shkollën e studimeve doktorale pranë Qendrës së

Studimeve Albanologjike, Tiranë. Një pjesë e mirë e artikujve të saj mbi këto fusha studimi janë të botuara në revistat *Studime Filologjike* dhe *Studime Historike*. Ndër këto kontribute përmendim në veçanti artikujt e mëposhtëm: “Sami Frashëri dhe letërsia e bejtexhinjve: një sprovë e parë për botimin e Divanit të Nezim Frakullës”, botuar në *Studime Filologjike*, n. 1-2, 2005; “Një përpjekje e hershme për njohjen e teksteve shqipe: Dervish Saliashkiu nga Tepelena dhe versioni i tij i Divanit shqip të Nezim Beratit”, botuar në *Studime Filologjike*, n. 1-2, 2012; “Trashëgimia letrare dhe procesi i kombformimit modern tek shqiptarët”, botuar në *Studime Filologjike*, n. 3-4, 2015; “Një përpjekje për vlerësimin e trashëgimisë së hershme letrare: Zef Jubani dhe Letërsia e Bejtexhinjve”, botuar në *Studime Filologjike*, n. 1-2, 2016; “Dy dokumente të panjohura mbi jetën e poetit Nezim Berati”, botuar në numrin 1-2, (2013) të revistës *Studime Historike*.

Prej vitit 2011 ajo mbante titullin shkencor Profesor i asociuar.

Nga janari i vitit 2017 Genciana Abazi-Egro ka qenë dhe titullare e lëndëve *Analizë Kritike e Ligjërimit* dhe *Semiotikë* pranë Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit në Universitetin European të Tiranës.

Largimi i saj nga jeta është një humbje e madhe për të afërmit e saj, po dhe për komunitetin shkencor të cilit ajo i përkiste.

Evalda PACI